

Procesverbal i Kuvendit të Anëtarëve të Platformës CiviKos

Data: 25 Prill 2025

Ora: 10:00

Vendi: Salla e Kuqe, Pallati i Rinisë, Prishtinë

Të pranishme: 39 organizata anëtare

Në ambientin e Sallës së Kuqe të Pallatit të Rinisë në Prishtinë, më 25 prill 2025, me fillim në orën 10:00, u mbajt Kuvendi i përgjithshëm i Anëtarëve të Platformës CiviKos. Në këtë mbledhje morën pjesë përfaqësues nga 39 organizata pas një periudhe mbi 5 vjeçare te mos mbajtjes së Kuvendit të Anëtarëve të CiviKos.

Mbledhja u hap me një fjalë hyrëse nga z. Dardan Kryeziu, Drejtor i Projekteve në Platformën CiviKos. Në paraqitjen e tij, ai shpjegoi se që nga data 1 mars 2025, CiviKos është pa një Drejtor Ekzekutiv, pasi Drejtorja e kaluar ka dhënë dorëheqje, ndërsa Bordi ka qenë joaktiv (me mandat të skaduar). Më tej, z. Kryeziu informoi se Kuvendi i përgjithshëm i CiviKosit nuk është mbledhur për thujtë pesë vite, çka e ka lënë organizatën në një gjendje të ndërlikuar institucionale dhe funksionale.

Pas kësaj hyrjeje, u propozua dhe u miratua në mënyrë unanime që z. Gersi Gashi, nga Qendra për Politika dhe Avokim, të jetë Kryesues i Kuvendit për këtë mbledhje. Në vijim, edhe Agjenda e Kuvendit u aprovua në mënyrë unanime nga të pranishmit, duke hapur rrugën për zhvillimin e diskutimeve dhe vendimmarrjeve.

Z. Dardan Kryeziu bëri një përmbledhje të shkurtër të punës së CiviKosit në 5 vitet e fundit, duke vënë theksin në bashkëpunimin me organizatat anëtare dhe institucionet qeveritare, në procesin e hartimit të legjislacionit sekondar që rregullon kontraktimin e shërbimeve publike nga organizatat e shoqërisë civile, aktivitetet që janë ndërmarrë si përgjigje ndaj pandemisë COVID-19, si dhe donatorët që kanë mbështetur projekteve të ndryshme të CiviKosit. Gjithashtu, ai ndau vizionin për të ardhmen e CiviKosit dhe planet për rifunksionalizim të plotë institucional, të organizatës.

Pas kësaj paraqitjeje, znj. Syzana Firza Puka, Menaxhere e Financave në Platforma CiviKos, prezantoi raportet financiare për periudhën 5 vjeçare të kaluar. Pasi përfundoi prezantimi, u hap hapësira për pyetje nga anëtarët, por nuk pati asnjë pyetje apo koment. Kryesuesi i Kuvendit, z. Gashi, vazhdoi me procedurën e miratimit të dokumenteve: raporti i punës u miratua plotësisht dhe pa kundërshtime, ndërsa raportet financiare u miratuan me dy abstenime dhe votat e tjera pro.

Mbledhja vijoi me prezantimin e kandidatëve për anëtarë të Bordit të ri. Në garë janë paraqitur tetë kandidatë: z. Bujar Kadriu nga Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar, znj. Dorina Davies nga YMCA Movement in Kosovo, z. Dren Puka nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, z. Driton Bajraktari nga Fondacioni Kosovar për Ndërmarrje Sociale, znj. Laura Kryeziu nga Leadership and Growth Council, znj. Nermin Mahmuti nga Community Development Fund, z. Qendrim Hoxha nga Leadership Development Association, dhe z. Shkumbin Arifi nga SHL - Kosova. Gjatë kësaj faze të mbledhjes,

nisi një debat i gjerë dhe i thellë rreth procedurës së zgjedhjes së Bordit, statutit të CiviKosit, funksionit të Bordit dhe definimit të kuorumit.

Z. Fidan Shaqiri nga Pontis parashtrori një pyetje të rëndësishme lidhur me prezencën e kandidatëve gjatë votimit, duke kërkuar qartësim nëse është e pranueshme që disa kandidatë për anëtarë Bordi të mos jenë të pranishëm fizikisht gjatë kësaj mbledhje dhe votimit. Z. Besim Kodra nga Shoqata e Pacientëve të Kosovës ngriti një çështje juridike, duke kujtuar se ligji për lirinë e asociimit nuk parasheh një Bord si organ drejtues, por përcakton Kuvendin si organin më të lartë vendimmarrës, dhe në këtë kontekst, shtroi pyetjen nëse është e nevojshme të ndryshohet statuti për të vazhduar tutje me zgjedhjen e Bordit.

Në përgjigje, z. Dardan Kryeziu sqaroi se prania e kandidatëve nuk është e detyrueshme me statut, megjithatë tregon një përkushtim ndaj rolit për të cilin kandidojnë. Tutje, në përputhje me statutin aktual të CiviKosit, z. Kryeziu shpjegoi që Bordi vepron si organ këshillues dhe i ndërmjetëm, dhe megjithëse nuk ka mandat ekzekutiv, për arsye praktike dhe operationale ai zgjedhet për të ndihmuar në menaxhimin e përditshëm të çështjeve të CiviKosit. Ai konfirmoi se Kuvendi mbetet organi më i lartë dhe se ky organizim është në përputhje me statutin aktual.

Znj. Iliriana Gashi nga Kosovo Women 4 Women pyeti nëse ka pasur ndonjë ndryshim në statut, meqë më parë ishte Bordi ai që zgjedhte Drejtorin Ekzekutiv. Dardan Kryeziu sqaroi se edhe në statutin aktual, Drejtori Ekzekutiv zgjedhet nga Bordi, bazuar në një delegim të bërë nga Kuvendi në të kaluarën.

Z. Valmiri Ismaili nga organizata Democracy + theksoi rëndësinë e CiviKosit për sektorin e shoqërisë civile, pavarësisht sfidave të përmendura. Megjithatë, ai vlerësoi se në këtë takim ishte i pranishëm një numër shumë i vogël i organizatave në krahasim me numrin e përgjithshëm të anëtarëve të CiviKos (mbi 300), dhe për këtë arsye propozoi që Bordi i ri të ketë një mandat të shkurtuar, për shkak të natyrës emergjente. Ai rekomandoi që pas zgjedhjes së Drejtorit të ri dhe identifikimit të anëtarëve aktivë, të mbahet një Kuvend tjetër për të zgjedhur një Bord me mandat të plotë.

Në këtë drejtim, z. Dardan Kryeziu sqaroi se aktualisht CiviKos ka rreth 60 organizata që konsiderohen aktive, bazuar në pjesëmarrje në aktivitete dhe/ose pagesën e anëtarësisë si kriter për këtë klasifikim. Sipas tij, shumë organizata janë joaktive, janë shpërbërë ose nuk janë të qasshme, dhe për të shmangur problemet me kuorumin, në të ardhmen mund të vendoset një sistem i shkallëzimit të anëtarësisë që do të përcaktojë të drejtën e votës dhe statusin e anëtarit aktiv.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Gashi, vërejti se statuti aktual nuk parasheh krijimin e një Bordi të përkohshëm. Z. Kryeziu shtoi se ndonëse statuti kërkon pesë anëtarë në Bord, në të kaluarën ka pasur edhe më shumë, dhe për të siguruar vazhdimësi, anëtarët tjerë mund të zgjedhen në një mbledhje tjetër të Kuvendit që mund të mbahet në vjeshtë, e që rrjedhimisht mandati i këtyre tre të fundit do të skadonte më vonë.

Nga KDI, z. Vullnet Bugaqku kërkoi sqarim se si janë përzgjedhur kandidatët për Bord, dhe z. Kryeziu konfirmoi se thirrja për nominime ka qenë e hapur për më shumë se një muaj para Kuvendit dhe organizatat anëtare kanë pasur mundësi të propozojnë kandidatë.

Z. Dren Puka nga KCSF shprehu gjithashtu shqetësim për kuorumin, por vuri në dukje se në përputhje me statutin, anëtarë të CiviKos konsiderohen ata që paguajnë anëtarësinë dhe janë aktivë, dhe ky arsyetim mbase mund të përdoret për të justifikuar kuorumin e nevojshëm për këtë mbledhje. Në linjë të ngjashme, z. Kushtrim Kaloshi nga ATRC theksoi se është e pamundur të pritët pjesëmarrja e të gjitha organizatave, dhe se situata kërkon një zgjidhje pragmatike. Ai shprehu shqetësim se si është arritur deri te kjo situatë dhe që CiviKos të operoj për 4 vite pa Bord me mandat, duke shtuar se ky Kuvend është i vonuar. Gjithashtu theksoi se përgjegjësia për mosfunksionimin e CiviKos bie mbi ata që për katër vite nuk kanë ndërmarrë asnjë hap për mbledhje të Kuvendit apo për rifunksionalizimin e Bordit.

Z. Valmir Ismaili nga Democracy + rikujtoi që qëllimi kryesor i këtij takimi është pikërisht rifunksionalizimi i CiviKosit, dhe kërkoi që të konfirmohet nëse organizatat pjesëmarrëse janë vërtet ato që konsiderohen aktive, në mënyrë që të mbrohet legjitimiteti i procesit. Nëse lista e organizatave aktive do të ishte e disponueshme, verifikimi do të ishte më i lehtë dhe i mundshëm.

Z. Mehmet Musa nga KRTC theksoi që Kuvendi, si organi më i lartë sipas ligjit, duhet të marrë përgjegjësinë për zgjedhjen e Drejtorit, dhe vuri në dyshim nëse është e arsyeshme që Drejtori të zgjidhet nga një Bord që konsiderohet si organ i ndërmjetëm.

Z. Zef Shala nga Shoqata Humanitare Bamirëse e Kosovës “Nëna Terezë” shprehu keqardhje për gjendjen aktuale në CiviKos dhe kërkoi që Bordi i ri të shqyrtojë ligjin për lirinë e asociimit, i cili nuk e parasheh një Bord si organ me kompetenca për shoqatat. Ai kërkoi që Drejtori të zgjedhet nga Kuvendi dhe të jetë përgjegjës ndaj tij. I bëri thirrje që Bordit të ri të jetë aktiv dhe i përgjegjshëm, jo njëlloj si Bordi i kaluar, duke reflektuar mbi parregullsitë e kaluara dhe rolin e pazëvendësueshëm që CiviKos luan për shoqërinë civile. Gjithashtu, sugjeroi që të procedohet me një proces të thjeshtuar duke pasur parasysh nevojën emergjente për zgjedhjen e një bordi të ri.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Gashi, theksoi se me statutin aktual, Drejtori zgjedhet nga Bordi. Ai shtoi se po të ishte bërë publike më herët lista e anëtarëve aktivë, mund të kishte shërbyer për të shmangur dilemat mbi kuorumin, por u shpreh se besimi në listën e verifikuar nga z. Dardan Kryeziu dhe Sekretariati mbetet bazë e mjaftueshme për të vazhduar me procesin.

Z. Besim Kodra nga Shoqata e Pacientëve sugjeroi që të gjitha organizatat të kontaktohen me email dhe të deklarojnë statusin e tyre si anëtarë, për shkak se shumë nga organizatat nuk kanë marrë fatura për anëtarësi dhe ndarja mes organizatave aktive dhe joaktive është ende e paqartë. Ai shtoi se disa organizata mund edhe të ndihmojnë CiviKosin në këtë proces. Z. Kryeziu u përgjigj se përveç pagesës së anëtarësisë, edhe pjesëmarrja në aktivitete është kriter për statusin aktiv, pikërisht për shmangien e pengesave në lidhje me kuorumin. Ai propozoi që të mbahet një Kuvend punues në të ardhmen për të sqaruar këto çështje, por theksoi se zgjedhja e Bordit është një emergjencë institucionale.

Në këtë frymë, z. Rexhep Gojnovci nga OJQ Akti propozoi të mos humbet më kohë dhe të vazhdohet me procesin e zgjedhjes, ndërsa z. Ideal Zhaveli nga Activism Roots theksoi që Bordi i ri duhet të zgjedhet sot dhe pastaj të thërrasë një Kuvend tjetër brenda këtij viti për të definuar çështjet që po diskutohen. Këto propozime u përkrahën nga pjesëmarrësit dhe Kryesuesi, z. Gashi, e vuri në votim vazhdimin e procesit, i cili u miratua.

Pas kësaj, filloi procesi i votimit. Çdo organizatë anëtare kishte të drejtë të votonte nga një deri në pesë kandidatë. Komisioni i numërimit të votave përbëhej nga Kryesuesi i Kuvendit, z. Gersi Gashi, z. Rexhep Gojnovci nga OJQ Akti, z. Ideal Zhaveli nga Activism Roots dhe një anëtar i Sekretariatit të CiviKosit. Ky komision do të numëronte votat dhe do të konstatonte 5 anëtarë e ri të Bordit që kanë më së shumti vota nga procesi.

Rezultatet e votimit ishin si më poshtë:

- Znj. Nermin Mahmuti mori 28 vota,
- Z. Dren Puka mori 21 vota,
- Z. Qendrim Hoxha mori 18 vota,
- Z. Bujar Kadriu mori 13 vota,
- Z. Shkumbin Arifi mori 12 vota ,
- Znj. Dorina Davies mori 11 vota,
- Znj. Laura Kryeziu mori 11, dhe
- Z. Driton Bajraktari mori 10 vota.

Në përfundim, Bordi i ri i përbërë nga znj. Nermin Mahmuti (CDF), z. Dren Puka (KCSF), z. Qendrim Hoxha (LDA), z. Bujar Kadriu (Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar), dhe z. Shkumbin Arifi (SHL-Kosova) u konstituua.

Pas zgjedhjes, z. Dren Puka mori fjalën duke falënderuar Bordin e kaluar për angazhimin, i cili angazhim ai tha se është evident me mbështetjen nga donatorët e prezantuar në fillim të mbledhjes. Gjithashtu theksoi se përgjegjësia e Bordit kishte përfunduar me skadimin e mandatit. Tashmë është detyrë e Bordit të ri që të rifunksionalizojë CiviKosin dhe të tjerat të lihen pas. Ai theksoi se CiviKos është platforma e vetme e këtij lloji në rajon, e cila i ka mbijetuar të gjitha sfidave dhe ndryshimeve të sektorit, ndaj dhe duhet të ruhet e zhvillohet nga të gjithë anëtarët.

Znj. Iliriana Gashi nga Kosovo Women 4 Women ndau përvojën e saj sfiduese si pjesë e Bordit të mëparshëm, duke kërkuar masa të qarta për përgjegjësinë e drejtuesve që japin dorëheqje pa respektuar afatet ligjore. Ajo shprehu shqetësimin që kurrë nuk kishte takuar Drejtoreshën e CiviKos, e as Bordin, pavarësisht kërkesave për takim me email. Në njërin prej rasteve tha se i ishte dhënë një arsyetim legjitim, por nuk ishin thirrur asnjëherë për takim.

Znj. Nermin Mahmuti nga CDF falenderoi organizatat për besimin dhe bëri thirrje për përgjegjësi kolektive dhe qasje bashkëpunuese nga Bordi i ri, duke theksuar se roli i anëtarit të bordit është pozitiv përgjegjësie më shumë se sa privilegji. Ajo tha se fryma që duhet të përcillet në diskutimet e Bordit është “ne”, dhe jo “unë. Kështu, ndihmojnë shoqërinë civile dhe sidomos CiviKosin në situatën aktuale. Tutje, ajo vlerësoi kontributin e z. Kryeziu duke thënë që pavarësisht sfidave të shumta, ka vazhduar punën në mënyrë të shembullt, dhe meritat për faktin që CiviKosi ka mbijetuar dhe ka bërë punë të mirë i takojnë atij, bashkë me stafin e Sekretariatit. Ajo theksoi rëndësinë e memories institucionale të tillë siç posedohet nga z. Kryeziu, në lidhje me zgjedhjen e një Drejtorit të ri. Megjithatë, ky është një proces që do të definohet pastaj nga Bordi, u shpreh ajo. Gjithashtu ajo shprehu edhe nevojën që secili anëtar të ndjejë përgjegjësi për funksionimin e CiviKosi dhe të kërkojnë mbledhje nëse vërejnë parregullësi, të tilla si këto që i diskutuan.

Z. Kushtrim Kaloshi nga ATRC përmbledhi sugjerimin e tij për Bordin e ri një koment të drejtpërdrejtë: Ndryshimi i vetëm që duhet të bëjë Bordi i ri është vetëm të mos bëjë çfarë është bërë nga Bordi i kaluar. Ai tha se fakti që CiviKos për 4 vite, ka qenë pa Bord me mandat, pa Kuvend të mbajtur, flet mjaftueshëm dhe i bën të mos jenë krenar as ata si anëtarë. Ai shprehu çudi se si asnjëherë nuk janë thirrur dhe mbajtur takimet e bordit dhe Kuvendit, edhe pse emrat e përfshirë janë figura kyqe të shoqërisë civile që i kuptojnë mirë këto procedura. Tutje ai tha se Bordi i ri duhet të zgjedh një Drejtor të përgjegjshëm që mban përgjegjësi shumë më të madhe se Drejtorja e kaluar, dhe kështu të përfaqësojë organizatat anëtare denjësisht. Në fund, ai shprehu mirënjohje dhe falënderim për stafin e CiviKosit, që edhe pse pa Kuvend, Bord, e Drejtor, kanë arritur të vazhdojnë punën dhe të mbajnë CiviKosin funksional.

Z. Valon Xhabali nga Ec Ma Ndryshe vuri në dukje se në fakt CiviKosi kishte një Drejtore Ekzekutive paktën në letër por pa përgjegjësi dhe pa takime me Bordin dhe Kuvendin.

Znj. Mexhide Demolli Nimani nga Lëvizja FOL uroi Bordin e ri, dhe shtoi se si organizatë do të jenë më kërkuese në të ardhmen. Ajo shprehu shpresën që CiviKosi të kthehet në misionin e tij fillestar dhe të mos funksionojë si konkurrent i organizatave, siç është perceptuar ndonjëherë. Ajo përmendi se, edhe pse këto parregullësi që u diskutuan kanë qenë evidente dhe organizatat kanë diskutuar mes vete për to në mënyrë joformale, të njëjtat nuk janë mobilizuar për të kërkuar llogari. Prandaj një pjesë e përgjegjësisë bie edhe mbi to, tha ajo.

Në fund, z. Kryeziu sqaroi për korrektësi se Drejtorja Ekzekutive e kaluar kishte dhënë dorëheqje më 1 mars të këtij viti, dhe menjëherë pas kësaj, ai kishte kontaktuar anëtarët e Bordit të fundit. Të gjithë kishin konfirmuar se nuk kishin më mandat aktiv, por janë takuar me z. Kryeziu për të diskutuar situatën aktuale dhe hapat tutje. Duke qenë se nuk kishte Bord funksional dhe as Drejtor Ekzekutiv, apo të paktën një ushtrues detyre të emëruar në mënyrë legjitime, organizimi i Kuvendit kishte mbetur mbi Sekretariat.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Gersi Gashi, pyeti nëse kishte çështje të tjera për diskutim. Meqë nuk kishte propozime apo diskutime të tjera, Kuvendi u mbyll dhe pjesëmarrësit u ftuan të vazhdojnë me një koktej rasti.

Përgatitur

Prishtinë, 25 Prill 2025.

Procesmbajtëse: Gresa Berisha- Sekretariati i Platforma CiviKos